

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË POGRADEC**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Pogradec me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 184, datë 31.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 942/11, datë 31.12.2012 , dërguar z. **Artan SHKËMBI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga Bashkia Pogradec të merren masa dhe të ngrihet grupi për menaxhimin strategjik, duke caktuar koordinatorin dhe të miratohet strategjia e riskut si dhe të krijohet regjistri i raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

**Brenda muajit janar 2013**

2. Nga Drejtoria e Financës të merren masa për ndjekjen dhe vjeljen e debitorëve duke zbatuar të gjitha hapat e mëtejshme ligjore për vlerën 14,576,409 lekë për 58 persona të pasqyruar në bilancin e vitit 2011, konkretisht:

- Për debitorët Th.T. 9,753 lekë dhe S. T. 18,481 lekë që punojnë aktualisht në bashki të bëhet ndalesa nëpërmjet listëpagesës.

- Për debitorët M.C. 756,895 lekë dhe V. C. 39,339 lekë ish punonjës të bashkisë të bëhet lajmërim debitimi pranë qendrave të punës dhe të kërkohet arkëtimi i këtyre vlerave.

Për subjektet debitor fizike dhe juridike me të cilët bashkia ka marrëdhënie kontraktuale ose qiraje si Firma Zh. 325,028 lekë dhe R. K. 330,000 lekë të bëhet ndalesa duke zbritur vlerat nga situacionet dhe vlerat e zbatimit kontratës.

**Brenda muajit**

**Maj 2013**

3. Të merren masa nga Drejtoria e Financës për të bërë hyrje veprat e artit (bustet) tek lulishte Fan Nolit për vlerën 2,500,000 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 178, datë 8.4.2011, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Brenda muajit**

**Janar 2013**

4. Të merren masa nga Bashkia Pogradec për miratimin e automjetit në përdorim të administratës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe të përdoret me efektivitet mbështetur në dokumentacionin e lëvizjeve sipas nevojave të administratës.

**Vazhdimisht**

5. Nga Bashkia Pogradec të merren masa për çregjistrimin e targave të dy autobusave dhe 1 veture tip Benz pranë DRSHTRR Korçë dhe të bëjë fletëhyrje skrapin, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të dalë në zbatim të këtij ligji.

### **Brenda muajit Shkurt 2013**

6. Nga administrata e Klub Futbollit të lidhen kontratat me ekipin e futbollit, sipas kërkesave të ligjit nr. 7961, datë 11.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me nenin 23/1 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005.

### **Brenda muajit Shkurt 2013**

7. Nga Sektori Mbështetës i Arsimit të merren masat për arkëtimin e 14 debitorëve të çerdhes për vlerën 30,700 lekë dhe 96 debitorëve të kopshtit për 275,880 lekë të vitit 2011, sipas pasqyrës nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur.

### **Brenda muajit Shkurt 2013**

8. Nga Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të merren masa që të bëhet një planifikim për tarifatat dhe taksat vendore sa më afër realitetit dhe pa rezerva si dhe të merren masa për realizimin e të ardhurave nga taksat vendore. Për çdo subjekt fizik ngarkesa tatimore të vendoset në nivelin e duhur për të mos patur diferencime. Të kryhen kontrole në subjekte për xhiron dhe shfrytëzimi i të dhënave të kryhet periodikisht. Të bëhet planifikimi dhe arkëtohet taksa e parkimit të përkohshëm të automjeteve publike me bileta.

### **Vazhdimisht**

9. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të ndiqen dhe të merren masa sipas procedurave ligjore për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore për vlerën 2,151,440 lekë, përkatësisht: për 5 debitorët e tarifës pastrimit me vlerën 55,070 lekë, për 7 debitorët e taksës parkimit për vlerën 36,000 lekë, për 3 debitorët e taksës reklamës në vlerën 89,100 lekë dhe 50,000 lekë hoteli, për 13 debitorët subjekte juridike në vlerën 1,549,080 lekë, për 10 debitorët subjekte biznesi i vogël në vlerën 136,750 lekë dhe për 25 debitorët institucione shtetërore në vlerën 235,440 lekë.

### **Brenda muajit Prill 2013**

10. Nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore të merren masat për licencimin e 36 subjekteve që ushtrojnë aktivitetet pa leje për vitin 2011 si dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të llogaritura ndaj disa subjekteve të pa licencuara për vlerën 67,500 lekë të pa arkëtuara.

### **Menjëherë**

11. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për vjeljen e debitorëve dhe licencimin e subjekteve pa leje, t'i kërkojë Titullarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak lëshimin e autorizimit të ndërhyrjes me forcë të Policisë Bashkiake për disiplinimin e debitorëve dhe subjekteve të pa licencuara, sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 neni 41, 88 dhe 93, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, nenin 17, pika 3 dhe 4, nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 dhe nenin 39/1 pika 14 e 15 të Rregullores së Bashkisë

### **Menjëherë**

12. Nga Bashkia Pogradec të merren masat për shfrytëzimin e plotë dhe sa më efektive të sipërfaqes 5,305 m<sup>2</sup> të marrë me qira nga subjekte private, për vjeljen e taksës tregut. Njëkohësisht të planifikohen të ardhurat e tregut sipas sipërfaqes së marrë me qira dhe të ndiqet arkëtimi i tyre periodikisht duke rillogaritur koston reale me gjithë elementët përbërës të saj ndaj tregtarëve.

### **Menjëherë**

13. Nga Bashkia Pogradec të merren masa për rishikimin e organikës së bashkisë dhe njërive vartëse, për ngarkesën e punonjësve, për arsimimin profesional, për përvojën e punës, sipas kërkesave të nenit 12 pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe të bëhet vlerësimi individual përkatës i tyre.

### **Brenda muajit Shkurt 2013**

14. Bashkia Pogradec të lidhë kontratën dhe të vendosë detyrimet e qirasë sipas dispozitave ligjore për ambientin e katit të parë të godinës së saj e cila është në shërbimin si bankomat e Tirana Bank dhe të kërkojë arkëtimin e detyrimit të llogaritur.

### **Brenda muajit Janar 2013**

15. Nga Bashkia Pogradec në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak të ndërpritet kontrata datë 15.9.2010 e nënshkruar me fondacionin E.-P., pasi ka konflikt interesi ku objekt i qiramarrjes dhe qiradhënies është i njëjti person, kryetari bashkisë, në kundërshtim me nenin 1, nenin 3/1,2,3,4/b, neni 5/d, nenin 6/1, nenin 21/2 etj të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, me nenin 37, 38, 42 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi Procedurave Administrative”, me nenin 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” si dhe me pikën 4/1 neni 88 të UMF nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit vitit 2011”. Ti kërkohet vlerësimi zyrtar ILDK Pasurisë dhe pas vlerësimit të zbatohen detyrimet ligjore.

**Brenda muajit Janar 2013**

16. Nga Drejtoria e Urbanistikës të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e vlerës **10,764,381 lekë** nga 34 subjektet ndërtuese, vlerë kjo e paarkëtuar si rezultat i mos pajisjes së subjekteve me lejen e shfrytëzimit dhe regjistrimin në ZVRPP, taksë mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

**Brenda gjashtëmuajorit të parë 2013**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga Bashkia Pogradec, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit me vlerën **46,411,128 lekë**, nga të cilat vlera 21,024,552 lekë në fushën e prokurimeve dhe zbatimin e kontratave për punë publike, vlera 12,063,013 lekë në fushën e administrimit material dhe vlera 13,323,563 lekë në fushën e urbanistikës, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera **3,429,652 lekë** nga KVO që përbëhet nga z. E. V., P. Z. dhe A. B. si ish-anëtar të KVO, për shkak të s’kualifikimit të gabuar të BOE “M. 92” sh.p.k dhe “E.” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i stadiumit dhe ambienteve rreth tij”, për të cilin duhet të shpallej fitues pasi ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 41,942,696 lekë, ose 3,429,652 lekë më pak se sa oferta e shpallur fituese. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Menjëherë**

2. Vlera **416,666 lekë** nga z. A. Sh. me detyrë Kryetar i Bashkisë, e cila përfaqëson TVSH për likuidimin që i është bërë subjektit fitues, për shkak se përgjithësisht procedura e ndjekur në tenderin “Vepra arti” është në kundërshtim me ligjin 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, rrjedhojë e të cilit është dhe llogaritja e likuidimi i fondit limit në kundërshtim me pikën 2 *Llogaritja e vlerës së kontratës të Kreu – t të II të VKM nr. 1, datë 10.1.2007.*

**Menjëherë**

3. Vlera **664,900 lekë** nga z. M. A., për shkak se disa nga çmimet e vendosura në zërat e punimeve në preventivin e tenderit “Rikonstruksioni i bllokut lagja nr. 5” janë në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr. 1027, datë 15.12.2010, rezultat i së cilës është rritja padrejtësisht e fondit limit.

**Menjëherë**

4. Vlera **11,219,394 lekë** nga z. V. Xh. dhe zj. Z. R., për shkak të shtyrjes së pajustificuar të afatit të kryerjes së punimeve dhe për rrjedhojë të moszbatimit të penalteteve të parashikuara në zbatim të kontratës lidhur midis palëve, në tenderin “Rikonstruksioni i Shëtitores 10 Dëshmorët e Pojskës”.

**Menjëherë**

5. Vlera **241,819 lekë** nga B. “K. B.” sh.p.k dhe “A.” sh.p.k, pasi janë likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i lumit të qytetit”.

6. Vlera **335,434 lekë** nga B. "G." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rehabilitimi i shkollës 9-vjecare "Kol Koci".
7. Vlera **382,142 lekë** nga B. "K. B." sh.p.k dhe "A." sh.p.k, pasi janë likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksioni i stadiumit dhe ambienteve përreth tij".
8. Vlera **55,980 lekë** nga B. "E." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Mirëmbajtje muzeu i qytetit".
9. Vlera **118,620 lekë** nga B. "Zh." sh.p.k dhe "B. -N" sh.p.k, pasi janë likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksion i shëtitores Fan Noli".
10. Vlera **720,600 lekë** nga O. "I." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksion i shëtitores "10 Dëshmorët e Pojskës".
11. Vlera **629,474 lekë** nga O. "I." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Naim Frashëri".
12. Vlera **51,532 lekë** nga O. "I." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksion i sheshit të monumenteve".
13. Vlera **250,284 lekë** nga O. "I." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksion i Zyrave të Bashkisë".
14. Vlera **269,520 lekë** nga O. "R." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Sistemim asfaltim Blloku Rinia".
15. Vlera **164,930 lekë** nga O. "R." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksioni i rrugës Kajo Karafili".
16. Vlera **428,405 lekë** nga O. "A." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksion trotuare në rrugët Rinia – Valuta – Mulla Kurti".
17. Vlera **215,820 lekë** nga O. "I. K." sh.p.k, pasi është likuiduar për punime të pakryera në tenderin me objekt "Rikonstruksion dhe shtesë shkolle 9 vjeçare Gjok Shqiptari".
18. Vlera **135,000 lekë**, nga O. "I.", pasi është situacionuar më tepër për objektin "Kopshti Liri Çomo", për zërin e punës "Përforcim +plotësim konstruksion druri çatie", i ofertuar "me çelësa në dorë", në tenderin e zhvilluar në vitin 2010 me objekt "Mirëmbajtje të institucioneve shkollore".
19. Vlera **56,220 lekë**, nga O. "I." pasi është situacionuar punë e pakryer në objektin "Kopshti Tomka Laçka", ndërsa sipas librezës së masave, rezulton se nuk është kryer asnjë volum pune, në tenderin e zhvilluar në vitin 2010 me objekt "Mirëmbajtje të institucioneve shkollore".

Për rastet nga pika 5 deri në pikën 19 të përshkruara më lart, likuidimi i punimeve të pakryera është në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.

#### **Menjëherë**

20. Vlera **433,360 lekë**, nga O. "I.K." pasi ka përfituar padrejtësisht edhe vlerën e tvsh që i përket pajisjeve, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", në tenderin e zhvilluar në vitin 2008, me objekt "Rikonstruksion + shtese shkollës 9 vjeçare "Gjok Shqiptari".

#### **Menjëherë**

21. Vlera **92,800 lekë**, nga O. "B." pasi ka përfituar padrejtësisht edhe vlerën e tvsh që i përket pajisjeve, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", në tenderin e zhvilluar në vitin 2008, me objekt "Rikonstruksion Qendrës Kulturore Sportive (Këndi i lojërave me dorë stadiumi)".

#### **Menjëherë**

22. Vlera **412,000 lekë**, nga B. "L. & A. K.", pasi ka përfituar padrejtësisht edhe vlerën e tvsh, që i përket pajisjeve, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", në tenderin e zhvilluar në vitin 2007 me objekt "Rikonstruksion + ndërtim i ri kompleksi "Koli Gusho".

#### **Menjëherë**

**23.** Vlera **300,000 lekë** nga A. Sh. 20,000 lekë, K. N. 20.000 lekë, E. V. 20,000 lekë, P. Z. 20,000 lekë, V. M. 20,000 lekë, A. B. 20,000 lekë, Th.T. 20,000 lekë, D. M. 20,000 lekë, Z. C. 20,000 lekë, R. S. 20,000 lekë, N. K. 20,000 lekë, Z. R. 20,000 lekë, I. T. 20,000 lekë, V. T. 20,000 lekë dhe ShPK “Sh. T. 20,000 lekë për shpenzime trajnimi në Athinë, në kundërshtim me VKM nr. 591, datë 23.7.2010 pika e dhe ë dhe me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 pika 3 dhe 4, “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011”.

#### **Brenda muajit Shkurt**

#### **2013**

**24.** Vlera **985,890 lekë** për shpenzime për dreka pritje përcjellje të përfaqësuesve shqiptar, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 “Për shpenzimet për pritje përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, me pikën b të VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2010”, me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 pika b, “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” si dhe me VKM nr. 432, datë 28.6.2006, përforcuar me pikën 58 të Udhëzimit nr. 1, datë 21.01.2010, përkatësisht: sipas urdhër shpenzimit nr. 225, datë 01.5.2010 për **37,000 lekë**, nr. 198, datë 14.4.2011 për **174,820 lekë** dhe sipas urdhër shpenzimit nr. 60, datë 7.02.2011 për **390,200 lekë**, sipas listave ngjitur, sipas urdhër shpenzimit nr. 97, datë 16.02.2010 për **108,000 lekë**, nr. 94, datë 12.02.2010 për **66,240 lekë** dhe sipas urdhër shpenzimit nr. 83, datë 8.02.2010, nr. 77, datë 5.02.2010, nr. 94, datë 12.02.2010, nr. 170, datë 23.3.2010, nr. 220, datë 9.4.2010, nr. 130, datë 01.5.2010 dhe nr. 102, datë 22.02.2010 për **209,630 lekë** për kokteje në 7 raste, mungojnë listat e pjesëmarrësve. Për 3 shumatat e fundit pa listë të miratuar pjesëmarrësish të gjenden ato dhe të bëhen ndalesat sipas përkatësisë, në të kundërt vlera 383,870 lekë (108000 +66240+209630) të zhdëmtohet nga komisioni blerjeve vogla V. T. A. B., T. M.dhe A. C. me nga 95,967 lekë secili.

#### **Brenda muajit Maj 2013**

**25.** Vlera **304,200 lekë** për tejkalim normative për shpenzime celulare nga z. A. Sh. për vitin 2010 dhe 2011, në kundërshtim me pikën 8 lidhja nr. 6 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë dhe publikë”.

#### **Brenda muajit Maj 2013**

**26.** Vlera **54,000 lekë** për dieta të përfituara në kundërshtim me VKM nr. 228, datë 13.4.2001 “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit tyre” i ndryshuar me VKM nr. 997, datë 10.12.2010.

#### **Brenda muajit Mars 2013**

**27.** Vlera **54,280 lekë** për karton jeshil me jashtë shtetit për makinën e bashkisë, sipas urdhër shpenzimit nr. 417, datë 13.8.2010 shpenzim i pajustificuar dhe pa bazë ligjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### **Menjëherë**

**28.** Vlera **877,617 lekë** për shpenzime karburanti të pajustificuar, përkatësisht vlera 440,847 lekë sipas fletëdaljes nr. 34, datë 19.4.2011 nga z. E. V. dhe vlera 436,770 lekë sipas fletëdaljes nr. 35, datë 20.4.2011 nga zj. K. N. Këto shpenzime janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionaret publik dhe nëpunësve civile”.

#### **Brenda muajit Tetor 2013**

**29.** Vlera **9,600,000 lekë** nga 34 veta, pasi kanë përfutuar kuotë ushqimore mbi limitin ligjor dhe pagesë hoteli pa dokumente justifikuese ligjore, sipas mandatpagesës nr. 2, datë 28.01.2011, nr. 2 datë 15.02.2011, nr. 4, datë 16.3.2011, nr. 6, datë 13.4.2011, nr. 8, datë 18.5.2011 dhe nr. 7, datë 12.7.2011, veprime në kundërshtim me pikën 2/II/2 të VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërblimit sportistëve si dhe për përfitim të

trajtimin për përgatitjen sportive”, me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

#### **Brenda muajit Nëntor 2013**

**30.** Vlera **41,760 lekë** për pagesa tepërta për punonjësit me kontrata të përkohshme për vitin 2011 në sektorin Mbështetës të Arsimit, pagesa këto të kryera në kundërshtim me kontratat përkatëse dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përkatësisht: V. A. 16,760 lekë, S. M. 2,000 lekë, P. G. 17,000 lekë, N. K. 3,000 lekë dhe D. L. 3,000 lekë .

#### **Brenda muajit Mars 2013**

**31.** Vlera **13,266 lekë** nga Xh. T., paguar tepër si diferencë çmimi të artikullit bukë më tepër se kontrata e mëparshme e “E. 94” shpk, për muajin Tetor, Nëntor e Dhjetor 2011, pasi është aplikuar çmimi 90 lekë nga 72 lekë që duhej, sipas fletëhyrjes nr. 41/1, datë 5.10.2011, nr. 42/1, datë 13.10.2011, nr. 42/4, datë 3.11.2011 dhe nr. 45/4, datë 02.12.2011, pagesa këto të kryera në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02 datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

#### **Brenda muajit Mars 2013**

**32.** Vlera **132,000 lekë** nga Z. R. për qira të paguar padrejtësisht për parkimin e 2 autobuzave të Ndërmarrjes Punëve Publike në vitin 2012, sipas kontratës datë 6.02.2012, pasi dy autobuzat janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe janë shkarkuar nga kontabiliteti në vitin 2011, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” etj.

#### **Brenda muajit Mars 2013**

**33.** Vlera **13,323,563 lekë** për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara për 1 % të financimit të studimeve urbanistike dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e reja nga subjektet të cilat kanë marrë leje ndërtimi.

#### **Brenda muajit Qershor 2013**

### **C. MASA ADMINISTRATIVE**

**1.** Në mbështetje të nenit 15 “Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, dhe nenit 10 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, t’i kërkojë INUK të vendos gjobë z. A. Sh., Kryetarit të Bashkisë për shkak se në 21 tenderë, mbikëqyrësit e punimeve të emëruar prej tij, nuk kanë qenë të pajisur me licence profesionale, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

**2.** - Në zbatim të nenit 15 “Sanksionet” të Kreu III-të, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, të vendosë gjobë 50,000 lekë për secilin mbikëqyrës të zbatimit të punimeve të ndërtimit si më poshtë:

**1. Z. M. A.** për shkeljet e konstatuara në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit në tenderët me objekt:

- “Rikonstruksion i shëtitores Fan Noli” i zhvilluar në vitin 2008 dhe shtesë kontrate në vitin 2009, me kontraktues B. “Zh.” sh.p.k. dhe “B. -N” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 118,620 lekë.

- “Rikonstruksion dhe shtesë shkolle 9 vjeçare Gjok Shqiptari” i zhvilluar në vitin 2008, me kontraktues O. “I. K.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 215,820 lekë.

**2. Z. V. Xh.** për shkeljet e konstatuara në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit në tenderët me objekt:

- “Rikonstruksioni i lumit të qytetit” i zhvilluar në vitin 2009, me kontraktues B. “K. B.” sh.p.k. dhe “A.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 241,819 lekë.

- “Sistemim asfaltim Blloku Rinia” i zhvilluar në vitin 2005, por që punimet kanë përfunduar në vitin 2006, me kontraktues O. “R.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 269,520 lekë.

3. **Z. T. B.** për shkeljet e konstatuara në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit në tenderët me objekt:

- “Rikonstruksion i rrugës Naim Frashëri” i zhvilluar në vitin 2006, me kontraktues O. “I.” sh.p.k. Mbikëqyrës të punimeve z. M. A. dhe T. B.. Vlera e likuiduar më tepër është 629,474 lekë.

- “Rikonstruksioni i rrugës Kajo Karafili” i zhvilluar në vitin 2006, me kontraktues O. “R.” sh.p.k. Mbikëqyrës i punimeve z. T. B.. Vlera e likuiduar më tepër është 164.930 lekë.

4. **Zj. Z. R.** për shkeljet e konstatuara në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit në tenderin me objekt:

“Rikonstruksion i shëtitores “10 Dëshmorët e Pojskës” i zhvilluar në vitin 2008 dhe shtesë kontrate datë 15.09.2009, me kontraktues O. “I.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 720,600 lekë.

5. **Zj. V. B.** për shkeljet e konstatuara në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit në tenderët me objekt:

- “Mirëmbajtje muzeu i qytetit” i zhvilluar në vitin 2008, me kontraktues O. “E.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 55,980 lekë.

- “Rikonstruksion i stadiumit dhe ambienteve përreth tij” i zhvilluar në vitin 2009, me kontraktues B. “K.B.” sh.p.k. dhe “A.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 382,142 lekë.

6. **Z. Dh. Gj.** për shkeljet e konstatuara në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit në tenderët me objekt:

- “Rikonstruksion i Zyrrave të Bashkisë dhe i sallës së mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë” i zhvilluar në vitin 2009, me kontraktues O. “A.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 250,284 lekë.

- “Rikonstruksion i sheshit të monumenteve” i zhvilluar në vitin 2009, me shtesë kontrate po në vitin 2009 dhe me kontraktues O. “I.” sh.p.k. Vlera e likuiduar më tepër është 51,532 lekë.

**3.** Mbështetur në ligjin nr. 9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, neni 13, pika 3, germa “a” t’i kërkohet Agjencisë Prokurimit Publik, të marrë masë për përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, të operatorit ekonomikë “P. 2” me seli në Pogradec, për një periudhë 2 vjeçare, pasi në tenderin e zhvilluar në vitin 2008, me objekt “Mirëmbajtje e institucioneve shkollore”, ka dorëzuar dokumente që përmbajnë të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, konkretisht:

Operatori ekonomik “P. 2”, ka paraqitur licencën e shoqërisë fotokopje të noterizuar, N. **3516/1**, me drejtues ligjor Y. A. dhe drejtues teknik D. M.

Ka paraqitur licencën e drejtuesit teknik D. M. **H/T 0196/3**, fotokopje të noterizuar, regjistruar në regjistrin themeltar nga data **7.3.2002**. Licenca është e dyshimtë, pasi dokumenti fotokopje ka mbivendosje

Licenca e operatorit ekonomik “P. 2”, N. 3516/1 është paraqitur për noterizim nga Y. A. që është drejtuesi ligjor i shoqërisë “P. 2”, dhe është noterizuar nga notere B. S. me nr. 308, datë 20.08.2008. Kjo licencë e paraqitur në këtë tender ka vlefshmëri deri me 11.05.2011, ose 9 vjet dhe është e nënshkruar nga Kryetari i Komisionit S. R.

Licenca e drejtuesit teknik D. M. H/T 0196/3, regjistruar në regjistrin themeltar nga data 7.3.2002 është fotokopje dhe është paraqitur për noterizim nga Y. A. dhe është noterizuar nga notere B. S. me datë 20.08.2008. Kjo licencë e paraqitur në këtë tender ka vlefshmëri deri me 11.05.2011, ose 9 vjet dhe është e nënshkruar nga Kryetari i Komisionit z. S. R., cilësuar në pikën 6.14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në pjesën e pasme të licencave “Tabela e Klasifikimit të punimeve të zbatimit”, është shënimi 939/ 15.06.06, që është i njëjtë me shënimin që ka licenca N.2611/5 e “Infinit” me seli në Pogradec.

Në tenderin e zhvilluar në vitin 2007, me objekt “Mirëmbajtje e institucioneve shkollore”.

Operatori ekonomikë “P. 2”, ka paraqitur licencën e shoqërisë 3516/1, me drejtues ligjor Y. A. dhe drejtues teknik D. M., regjistruar në regjistrin themeltar nga data 7.09.2002, me vlefshmëri deri me datën 7.09.2007 dhe është e nënshkruar nga Kryetari i Komisionit A. D.

Ka paraqitur licencën e drejtuesit teknik D. M. H/T. 0196/3, regjistruar në regjistrin themeltar nga data 7.9.2002 dhe është nënshkruar nga Kryetari i Komisionit A. D., cilësuar në pikën 6.21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **D. MASA DISIPLINORE**

**a.** Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kontratën individuale të punës, kërkojmë nga Kryetari i Bashkisë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

**“Zgjidhje të kontratës punës”**, për:

**1. R. R.** me detyrë Përgjegjëse e Financës të Klub Futbollit Pogradec, njësi vartëse e bashkisë Pogradec.

-Për mos përmbushje dhe paaftësi në kryerjen e detyrës së financieres së klub futbollit.

-Për mos plotësim kriteresh ligjore që kërkohen në detyrën e përgjegjëses së financës, pasi nuk ka arsimin e lartë ekonomik, por është me arsim të mesëm të përgjithshëm. Njëkohësisht nuk ka përvojë pune në fushën e menaxhimit financiar dhe të financave publike. Mos plotësimi i këtyre kriterëve është në kundërshtim me nenin 12 pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ku citohet: “Nëpunësi zbatues i njësisë publike është punonjës i nivelit të lartë të menaxhimit të njësisë publike, me diplomë universitare të nivelit dytë në shkencat ekonomike ose juridike, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike”.

-Për kryerjen e pagesa të pa ligjshme për vlerën 9,600,000 lekë dëm ekonomik për 34 veta sportistë të klub futbollit, pasi kanë përfituar pagesa të tepërta mbi limitin ligjor për kuotën ushqimore dhe pagesën e hotelit dhe pa dokumentacioni justifikues ligjor, veprime këto në kundërshtim me pikën 2/II/2 të VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërblimit sportistëve si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

-Për mos likuidimin e pagesave të futbollistëve nëpërmjet bankës, por me anën e arkës.

-Për mangësi në hartimin e listë pagesave dhe mungon nënshkrimi i financieres dhe pagatorit, mungon numri i identitetit të marrësve të të hollave. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Më hollësisht shih procesverbalin nr. 9 datë 5.10.2012.

**2. L. V.** me detyrë inspektore kontrolli e taksave vendore në zona.

**3. A. K.** me detyrë inspektore kontrolli e taksave vendore në zona.

**4. V. B.** me detyrë inspektore kontrolli e taksave vendore në zona.

**5. V. T.** inspektore e taksave familjare.

**6. K. I.** inspektor zone dhe inspektor tregu.

për shkeljet e mëposhtme:

-Për punë të dobët dhe mungesë efektiviteti në kontrollet e kryera pranë subjekteve të biznesit të vogël për vitin 2010 dhe 2011.

-Për mos kryerjen efektive të kontrolleve në subjektet fizike që ushtrojnë aktivitet pa leje, mos ndjekjen e arkëtimeve të subjekteve debitorë dhe mos evidentimin e plotë të subjekteve të mbyllura.

-Për mungesë bashkëpunimi me policinë bashkiake për disiplinimin e subjekteve të pa licencuara dhe debitorë.



-Për verifikim e kronometrim të pjesshëm të subjekteve në terren.

-Për mos shfrytëzimin e të dhënave të subjekteve të biznesit vogël për importet që kryejnë, thesarin, të dhënat për rimbursimet e farmacive, për efekt të rivlerësimit shtesë dhe për efekt kontrolli të xhiros së vet deklaruar nga subjektet.

-Për mos vendosje sanksionesh për subjektet fizike që nuk kanë mbajtur librat e shitjes e blerjes, regjistrat dhe dokumentacionin për vitin 2010 dhe 2011, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" kreu XIV Sanksionet neni 118.

-Për mos vendosje bllokime e konfiskime ndaj 36 subjekteve të biznesit vogël që ushtrojnë aktivitet pa leje, sanksione këto të përcaktuara me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 41, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 7.4.2011, pika 1 sipas nenit 121.

-Për nivele të ulëta taksimi dhe planifikimi të taksës së tregut për çdo tregtar.

-Për mos administrim të tregut çdo ditë me bileta dhe mos arkëtim ditor të ardhurave tyre.

Problemet e sipërcituara janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.5.2007 "Për sistemin e taksave vendore", udhëzimit e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 7.4.2011.

Më hollësisht shih procesverbalin nr. 11 datë 18.10.2012.

**" Shkarkimin nga detyra", për:**

**1. Zj. Z. R.** me detyrë aktualisht Drejtoreshë Ndërmarrjes Punëve Publike njësi vartëse e Bashkisë Pogradec dhe kalimin e saj në një detyrë në nivel specialiste, për shkeljet e mëposhtme:

- Për paaftësi menaxhuese të Ndërmarrjes Punëve Publike pasi 2 autobuzat e transportit urban në linjën Pogradec-Tushemisht për 3 vite radhazi rezultojnë pa efektivitet, pa eficientë dhe pa ekonomikitet, me humbje financiare ku me të ardhurat nga shitja e biletave nuk mbulojnë shpenzimet e veta, madje as pagën e një faturino, për vitin 2009, 2010 dhe 2011, çka bie ndesh me nenin 2, 5/1, 8 etj të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Për mos marrjen e masave, për mungesën e analizës dhe mungesën e propozimit ndaj kryetarit bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, për bllokimin e autobusëve ose lënien në përdorim të 1 autobusi, çka do të zbutej humbja dhe do kurseheshin shpenzimet.

- Për mos arkëtimin e qirave brenda afatit të kontratave për vitin 2011 për vlerën 83,200 lekë në 4 raste dhe mos llogaritjen e penaltiteteve për vonesat e pagesave qirave.

- Për mangësi në përpilimin e kontratave, pasi nuk përcaktohen penaltitetet dhe nuk përcaktohen personat për ndjekjen e zbatimit të kontratës, kushte të domosdoshme të kontratave, si dhe pasaktësi në mbështetjen ligjore, në kundërshtim me kontratat përkatëse dhe me VKM nr. 162, datë 7.3.2007, nr. 1712, datë 24.12.2008, nr. 316, datë 8.4.2009, ndryshuar me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 "Për dhënien me qira ose enfiteoze të pasurive ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore".

Më hollësisht shih procesverbalin nr. 10 datë 5.10.2012.

**2. Z. K. G.** me detyrë sekretar klubfutbollit, për shkeljet e mëposhtme:

- Për lejimin e kryerjes të pagesa të pa ligjshme për vlerën 9,6 milion lekë dëm ekonomik ndaj 34 sportistëve të klub futbollit, pasi kanë përfituar tepër kuotë ushqimore dhe pagesë hoteli mbi limitin ligjor dhe pa dokumente justifikuese ligjore, në kundërshtim me pikën 2/II/2 të VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 "Për kriteret.dhe mënyrën e shpërblimit sportistëve si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin

financiar të punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, me ligjin nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos vjeljen e asnjë të ardhure nga shitja e biletave nga 2 milion lekë të planifikuara për vitin 2011, çka bie ndesh me nenin 3/9 të ligjit nr. 9376 datë 21.4.2005 i ndryshuar “Për sportin”.

- Për mos lidhje të kontratave të punës mes sportistëve dhe përfaqësuesit të ekipit futbollit të Bashkisë për vitin 2011, në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 11.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me nenin 23/1 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 i ndryshuar.

Më hollësisht shih procesverbalin nr. 9 datë 5.10.2012.

**b.** Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

### **“Largim nga shërbimi civil” neni 25, pika 3, germa d**

**1. Z. E. M.** me detyrë Specialist i Nivelit të Lartë për Sekretarinë Teknike për periudhën 2007 - 2011 për:

- Mos zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 20 dhe ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” në mbajtjen e protokolleve të mbledhjeve të KT dhe KRRT.

- Për mungesë përgjegjshmërie në ushtrimin e detyrës për llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve financiare për financimin e studimeve urbanistike dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë e shoqëruar me dëm ekonomik në shumën 7,652,559 lekë në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

**2. Zj. V. G.** me detyrë ish-Specialiste e Nivelit të Lartë (Njësia e Planit Rregullues dhe e Projekteve) për vitin 2006

**3. Zj. F. B.** , me detyrë ish-Drejtoresh e Urbanistikës për vitin 2006

- Për mungesë përgjegjshmërie në ushtrimin e detyrës në llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve financiare për financimin e studimeve urbanistike dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë e shoqëruar me dëm ekonomik në shumën 5,771,004 lekë për vitin 2006 në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

**4. Zj. S. A.** me detyrë arkëtare, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos plotësim kriteresh ligjore në detyrën e arkëtares të bashkisë, pasi është me arsim të mesëm industriale, në vend të arsimit ekonomik dhe nuk ka përvojë pune si arkëtare.

- Për shkelje e mangësi në kryerjen e detyrës së arkëtares.

- Për mos regjistrimin e 13 mandatpagesave për vlerën 112,640 lekë duke i mbajtur jashtë kontabilitetit.

- Për mbajtje gjendje arke fizike formalisht për 1 vit të vlerës 112,640 lekë.

- Për lejimin e daljes nga arka të parave të pa shoqëruara me dokumentet bazë si fletëhyrjet dhe procesverbalet për mallrat e blera apo shërbimet e kryera sipas 13 mandat pagesave.

- Për nxjerrje të parave nga arka pa urdhër të titullarit dhe prerje të mandat pagesave jashtë numrit kronologjik si dhe me mangësi në plotësimin e tyre.

- Për mos respektim të limitit arkës pasi arka paraqitet e fryrë me të holla tej limitit saj.

- Për mos rekordin me financën, pasi libri i arkës nuk nënshkruhet nga përgjegjësja e financës, për gjendjen fizike të të hollave në fund të çdo muaji.

Probleme e cituara më lartë janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, me nenin 13 pika c të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin

financiar dhe kontrollin”, me pikën 62-68 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**5. Zj. Zh. E.,** me detyrë magazinierë, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos plotësim kriteresh ligjore në kryerjen e detyrës së specialistes pagave dhe magazinieres, pasi nuk ka arsimin ekonomik por është me arsim të mesëm bujqësor, jashtë profilit të vendit punës.

- Për mos administrim të karburantit, pasi ka bërë dalje karburantin për makinat e bashkisë njëherësh për gjithë vitin, në vend të daljeve periodike sipas nevojave të shërbimeve.

- Për furnizim me karburant përveç shoferit në organikë dhe të 2 persona të tjerë të cilët nuk kanë tagër për tërheqje pasi nuk janë shoferë në organikë, sipas fletëdaljes nr. 34, datë 19.4.2011 dhe fletëdaljes nr. 35, datë 20.4.2011 me dëm ekonomik për vlerën 877,617 lekë.

- Për pranim të fletudhëtime të parregullta, për 2 automjetet e bashkisë për vitin 2011 pasi janë plotësuar formalisht, kanë korrigjime, nuk kanë autorizimin e titullarit, nuk përcaktohet qëllimi i udhëtimit, nuk përputhen kilometrat e përshkruara me tabelën e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit.

Për pranimin e fletudhëtimeve fiktive për Benzin PG2929B, pasi janë plotësuar 2760 km pas periudhës së nxjerrjes jashtë përdorimit dhe shkarkimit të tij nga kontabiliteti nga data 9 dhjetor 2011 deri në fund vitit 2011.

- Për prerjen e fletëdaljes nr. 175 dhe nr. 176 datë 9.12.2011 të 2 Autobuzave dhe 1 Benzi të nxjerrë jashtë përdorimit, në kushtet e mos heqjes targave dhe mos çmontimit të automjeteve për skrap dhe pjesë këmbimi.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” .

**6. Zj. A. B.** me detyrë llogaritare e magazinës, për shkeljet e mëposhtme:

- Për lejimin daljes së karburantit për automjetet e bashkisë njëherësh për gjithë vitin nën mungesën e rakordimit të kilometrave të përshkruara me sasinë e harxhuar dhe të furnizuar.

- Për lejimin e furnizimit me karburant përveç shoferit në organikë dhe 2 persona të tjerë, sipas fletëdaljes nr. 34, datë 19.4.2011 dhe fletëdaljes nr. 35, datë 20.4.2011 me dëm ekonomik për vlerën 877,617 lekë.

- Për pranimin e fletudhëtimeve të parregullta për 2 automjetet e bashkisë për vitin 2011 pasi janë plotësuar formalisht, kanë korrigjime, nuk kanë autorizimin e titullarit, nuk përcaktohet qëllimi i udhëtimit, nuk përputhen kilometrat e përshkruara me tabelën e miratuar.

- Për mos hartimin e miratimin normativave mujore të harxhimit karburantit për 2 automjetet e bashkisë.

- Për pranim të fletudhëtimeve fiktive të plotësuara pas nxjerrjes jashtë përdorimit të Benzit PG2929B pas periudhës së shkarkimit nga kontabiliteti nga data 9 dhjetor 2011 deri në fund vitit 2011.

- Për pranimin dhe kontabilizimin e fletëdaljes nr. 175 dhe nr. 176 datë 9.12.2011 të 2 Autobuzave dhe 1 Benzi të nxjerrë jashtë përdorimit, në kushtet e mos heqjes targave dhe mos çmontimit të tyre.

- Për mos zbatim të urdhrit titullarit nr. 108, datë 13.12.2010 për nxjerrjet jashtë përdorimit të 2 autobuzave të NPP, pasi nuk është kryer asgjësimi i plotë i tyre për ti çmontuar si skrap dhe si pjesë këmbimi, çka vërtetohet me 2 procesverbalet datë 18.5.2012 dhe 4.5.2012 dhe me kontratën datë 6.02.2012 të qirasë për ish 2 autobuzat e NPP për vitin 2012.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” .

**7. Zj. E. L.** me detyrë audituese e brendshme, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos planifikim dhe realizim auditimi periodik të drejtorive dhe njësive vartëse të Bashkisë.
  - Për mungesë efektiviteti në auditimin e drejtorive dhe njësive vartëse të Bashkisë.
  - Për nivel të dobët zbulimi dhe mungesë të forcës goditje të auditimit brendshëm.
  - Për mungesë informacioni ndaj kryetarit bashkisë për problemet dhe mangësitë e zbuluara, për parandalimin e tyre dhe përmirësimin në të ardhmen si dhe nxjerrjen e përgjegjësiwe përkatëse të shoqëruara me masat përkatëse, çka kanë munguar.
  - Për punë të dobët audituese, pasi nuk janë kapur dhe nuk janë parandaluar disa pagesa të paligjshme të trajtuara në Raportin Përfundimtar Auditimit të KLSH-së, në drejtim të shpenzimeve për dieta, karburant, celulare, pritje përcjellje, qira objektësh, në drejtim të administrimit mjeteve transportit publik, dhe probleme të konfliktit interesit etj, çka ka krijuar efekte negative financiare dhe dëm ekonomik.
  - Për mos auditimin e çerdhes dhe kopshtin e qytetit lidhur me fenomenin e mos pagesës së kuotave ushqimore nga familjarët, duke lejuar kryerjen e shpenzimeve për trajtimin e fëmijëve gjatë vitit 2012 pa paguar më parë detyrimin e vitit kaluar 2011.
  - Për mungesë auditimi të administrimit të taksës tregut, lidhur me mos vjeljen e saj për gjithë sipërfaqen, mos administrimin e tregut me bileta ditore.
  - Për mos planifikimin dhe lënien jashtë mbikëqyrjes audituese të klub futbollit, pasi janë kryer pagesa të pa ligjshme për vlerën 9.6 milion lekë dëm ekonomik.
- Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010.

**“Kalimi në një detyrë të një klase më të ulët për një periudhë 1 vit”, neni 25, pika 3, germa c**

- 1. Zj. V. T.** me detyrë Drejtoreshë e Financës dhe Taksave Vendore, për shkeljet e mëposhtme:
- Për mos ndjekjen dhe vjeljen e llogarisë debitorë për vlerën 14,576,409 lekë për 58 persona të pasqyruar në bilanc.
  - Për mos kryerjen e ndalesave për debitorët e punësuar në bashki ose ish-punonjës të bashkisë ndaj të cilëve nuk ka shkresa zyrtare dhe nuk disponohen masa tjera për bllokimin e pagesës pranë qendrës së punës ose thesarit deri në likuidimin e detyrimit prapambetur.
  - Për mos kryerjen e ndalesave ndaj subjekteve juridike e fizike debitor me të cilët bashkia ka marrëdhënie kontraktore për shërbimet që kryejnë dhe për mos marrje masa shtrënguese pranë qendrave të punës ose bllokime të llogarive bankare. Për mos kontabilizim të debitorëve taksave vendore për vitin 2011.
  - Për shkarkimin nga kontabiliteti dhe bilanci i vitit 2011 të 2 Autobuzave dhe 1 autoveture tip Benx, pa procesverbalin e komisionit të asgjësimit, pa dokumentin për heqjen e targave si dhe pa bërë çmontimin e tyre, pra pa u asgjësuar në fakt.
- Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”.
- Për mosrealizim të ardhurave nga taksat vendore në total dhe strukturë për vitin 2011, pasi taksat vendore janë realizuar 66 % ose 43,068 mijë lekë mungesë të ardhurash.
  - Për punë të dobët dhe mungesë sanksionesh ligjore si bllokime e sekuestrime ndaj 36 subjekteve të biznesit vogël që ushtrojnë aktivitet pa leje, sanksione këto të përcaktuara me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 41, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 7.4.2011.
  - Për mos akt rekordin me degën e tatimeve Korçë për subjektet juridike dhe mos bashkëpunim me policinë bashkiake në drejtim të disiplinimit subjekteve të palicencuara dhe debitorëve.
  - Për mos marrjen e masave për arkëtimin e vlerave debitorë të taksave vendore për vitin 2011, për 13 subjekte juridike për vlerën 1,549,080 lekë, për 10 subjekte biznes i vogël për vlerën 136,750 lekë dhe 25 institucione shtetërore për vlerën 235,440 lekë.

Këto veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimit e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë” etj.

**2. Zj. R. S.**, me detyrë ish-Drejtoreshë e Taksave Vendore, aktualisht Drejtoreshë Personeli në Bashki, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mosrealizim të ardhurave nga taksat vendore në total dhe strukturë për vitin 2010 dhe 2011, konkretisht për vitin 2011 taksat vendore janë realizuar 66 % ose për vlerën 43,068 mijë lekë mungesë të ardhurash.

-Për planifikimin me rezerva të disa taksave vendore për vitin 2011, konkretisht për taksën e tregut për vlerën 29,250,000 lekë për sipërfaqen e pashfrytëzuar.

-Për mos kontroll lidhur me ngarkesën tatimore të disa subjekteve fizike.

-Për punë të dobët dhe mungesë sanksionesh ligjore si bllokime e konfiskime ndaj 56 subjekteve të biznesit vogël që ushtrojnë aktivitet pa leje, sanksione këto të përcaktuara me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 41, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 7.4.2011.

-Për mos akt rakordim me drejtorinë e shfrytëzimit automjeteve për taksën e regjistrimit të automjeteve, në kundërshtim me udhëzimin e përbashkët të MPVD dhe MF nr. 9, datë 04.02.2003 “Për regjistrimin përvitshëm të mjeteve transportit”. Për mos rakordim me degën e tatimeve Korçë për subjektet juridike.

-Për punë të dobët në vjeljen e debitorëve për taksat vendore për vitin 2011 konkretisht, për 13 subjekte juridike debitorë për vlerën 1,549,080 lekë, për 10 subjekte biznes i vogël për vlerën 136,750 lekë dhe 25 institucione shtetërore për vlerën 235,440 lekë.

-Për mungesë bashkëpunimi me policinë bashkiake në drejtim të disiplinimit subjekteve pa certifikatë tatimore dhe debitorë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 7.4.2011.

#### **“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa a**

**1. Zj. M. Ç.** me detyrë financiere në njësinë vartëse Sektori Mbështetës Arsimit Pogradec, për shkeljet e mëposhtme:

-Për pagesa tepërta në 5 raste për vlerën 41,760 lekë dëm ekonomik, për punonjësit me kontrata të përkohshme për vitin 2011, në kundërshtim me kontratat dhe urdhrat e titullarit.

-Për mos mbajtje dokumentacioni justifikues ose listë prezencave për punën e kryer për punonjësit me kontrata pune me kohë të pjesshme.

-Për të meta dhe mangësi lidhur me nxjerrjet jashtë përdorimit për vitin 2011, pasi materialet për jashtë përdorimi nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

-Për mangësi në mbajtjen e procesverbalit të asgjësimit.

-Për lejimin e shkarkimit nga magazina të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit pa prerë fletëdaljen, por janë shkarkuar nga kontabiliteti ekstra kontabël për vlerën 4,062,966 lekë.

-Për probleme tjera të trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit.

Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”.

**2. Zj. Zh. T.** me detyrë magazinierë në njësinë vartëse Sektori Mbështetës Arsimit Pogradec, për shkeljet e mëposhtme:

-Për blerje të artikullit bukë me çmim më të lartë se firma kontraktuese për vlerën 13,266 lekë dëm ekonomik.

-Për bërjen hyrje të artikullit bukë me mungesë të dokumentacionit bazë, si urdhrin titullarit, kontratës dhe procesverbalit të komisionit, sipas fletëhyrjeve nr. 41/1, datë 5.10.2011, nr. 42/1, datë 13.10.2011, nr. 42/4, datë 3.11.2011 dhe nr. 45/4, datë 02.12.2011 për 737 copë bukë, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02 datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

-Për mos prerjen e fletëdaljes për materialet e nxjerra jashtë përdorimit, të cilat janë shkarkuar nga magazina dhe kontabiliteti ekstra kontabël për vlerën 4,062,966 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me ligjin nr. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”.

**3. Zj. I. Ll.** kryetare komisionit të asgjësimit, në njësinë vartëse Sektori Mbështetës Arsimit Pogradec, për shkeljet e mëposhtme:

**4. Z. H. L.** anëtar i komisionit të asgjësimit, në njësinë vartëse Sektori Mbështetës Arsimit Pogradec, për shkeljet e mëposhtme:

-Për të meta dhe mangësi lidhur me nxjerrjet jashtë përdorimit për vitin 2011, pasi materialet janë nxjerrë jashtë përdorimit pa u miratuar në Këshillin Bashkiak.

Për të meta dhe mangësi në mbajtjen e procesverbalit të asgjësimit.

Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Për sa më sipër është mbajtur proces verbali nr. 7 datë 21.9.2012.

**5. Zj. A. T.** inspektore e ardhurave, për shkeljet e mëposhtme:

**6. Zj. A. H.** specialiste e përpunimit të dhënave e faturimit në taksat vendore, për shkeljet e mëposhtme:

**7. Zj. V. Ç.** përgjegjëse rimaturim xhiroje dhe llogaritje takse në taksat vendore, për shkeljet e mëposhtme:

**8. Zj. V. L.** llogaritare ardhurave në taksat vendore, për shkeljet e mëposhtme:

**9. Z. P. K.** inspektor maturimi i taksave vendore, për shkeljet e mëposhtme:

**10. Zj. K. G.** arkëtare në taksat vendore, për shkeljet e mëposhtme:

**11. Z. F. Sh.** me detyrë inspektor tregu, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos realizim të ardhurash nga tregu për vitin 2011 në masën 93 % ose 932 mijë lekë mungesë të ardhurash.

-Për rezerva në planifikimin e taksës tregut për vlerën 29,250,000 lekë për sipërfaqe 3,125 m<sup>2</sup> të pa shfrytëzuar.

-Për mos administrimin e taksës tregut me bileta ditore nga inspektori i tregut.

-Për mos arkëtim ditor të taksës tregut, por padrejtësisht është kryer me mandatarkëtime mujore për çdo tregtar nga arkëtarja e taksave.

-Për aplikimin e nivelit të ulët të taksës së tregut në masën 30 lekë m<sup>2</sup> në ditë.

-Për mos vjelje të taksës tregut për mish e peshk si dhe fruta perime.

-Për mos aplikim sanksione për vonesë e shkelje afati të pagesës së kësteve tatimore ndaj subjekteve biznesit vogël, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 17 “Kundërvajtjet dhe sanksionet”, pika 1, shkronja ‘a’, dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” kreu XIV Sanksionet neni 114 Mospagimi në afat.

-Për diferenca në aplikimin e tarifës pastrimit për vitin 2011 ndaj 6 subjekteve biznesit vogël, çka bie ndesh me Vendimin e Këshillit Bashkiak.

-Për ngarkesa të pjesshme të detyrimeve taksave vendore për disa subjekte fizike.

-Për mosrealizim dhe rënie të grafikut të ardhurave vendore në total dhe strukturë për vitin 2010 dhe 2011.

-Për mos kryerje kontrolli e verifikimi për saktësinë e bazës tatueshme të deklarimit të xhiros të subjekteve fizike.

-Për diferencime në aplikimin e tarifës pastrimit për vitin 2011 ndaj 6 subjekteve biznesit vogël, çka bie ndesh me Vendimin e Këshillit Bashkiak.

-Për mos rivlerësim shtesë të taksave vendore ndaj subjekteve biznesit vogël për vitin 2010 dhe 2011.

-Për mos aktrakordim me drejtorinë e shfrytëzimit automjeteve për taksën e regjistrimit të automjeteve dhe me degën e tatimeve Korçë për subjektet juridike.

-Për punë të dobët në vjeljen e debitorëve për taksat vendore për vitin 2011 konkretisht, për 13 subjekte juridike debitorë për vlerën 1,549,080 lekë, për 10 subjekte biznesi i vogël për vlerën 136,750 lekë dhe 25 institucione shtetërore për vlerën 235,440 lekë.

-Për mungesë bashkëpunimi me policinë bashkiake në drejtim të disiplinimit subjekteve pa certifikatë tatimore dhe debitorë.

Për sa më sipër është mbajtur proces verbali nr. 11, datë 18.10.2012.

Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimit e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë” etj.

**12. Z. R. A.** me detyrë veteriner, për shkeljet e mëposhtme:

**13. I. G.** me detyrë veteriner, për shkeljet e mëposhtme:

-Për hartimin dhe aplikimin e tarifave për shërbimin veteriner për vitin 2011 në nivele shumë të ulëta.

-Për mosrealizim të ardhurash të planifikuara për vitin 2011 në masën 33 % ose 605 mijë lekë mungesë të ardhurash.

-Për mos vjeljen e të ardhurave të tarifës veterinerë të planifikuar.

-Për mos evidentimin dhe ndjekjen e debitorëve për këtë tarifë, çka ka bërë që niveli i taksës therjes të jetë në nivelet më të ulëta.

-Për planifikimin e pa studiuar dhe vendosje tarifa për shërbimin veteriner në nivele minimale si për të trashat dhe të imtat, ndërsa për peshk nuk ka.

-Për mos aplikim të vjeljes taksës therjes në gjitha pikat e qytetit por vetëm në thertoren e qytetit.

Për sa më sipër është mbajtur proces verbali nr. 11, datë 18.10.2012.

**14. Zj. T. M.** në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve vogla.

**15. Z. A. Ç.** në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve vogla.

për shkeljet e mëposhtme:

-Për shkelje në procedurat e prokurimeve të drejtpërdrejta në 7 raste me efekte financiare për vlerën 1,285,890 lekë për vitin 2010 dhe 2011, për pritje e përcjellje, trajnime, dhe shërbime tjera, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

-Për mos zhvillim tenderimesh në 2 raste shërbimesh për vlerën 1,1 milion lekë, por është proceduar me prokurim të drejtpërdrejtë si shërbime me vlera të vogla, duke copëzuar fondin me vlera nën 400 mijë lekë, përkatësisht për vlerën 603,000 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 236, datë 11.5.2011 dhe nr. 237, datë 11.5.2011 si dhe për vlerën 497,000 lekë sipas urdhër shpenzimit nr. 278, datë 23.6.2011 dhe nr. 278, datë 23.6.2011, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me kreun II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit” pika 1 “Kufijtë monetarë” shkronja B, me kreun IV shkronja C dhe me udhëzimin

e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 4.

-Për mangësi dhe parregullsi të dokumentacionit blerjeve vogla.

Për sa më sipër është mbajtur proces verbali nr. 3 datë 14.9.2012.

**16. Zj. E. T.** në cilësinë e anëtarit të komisionit nxjerrjes jashtë përdorimit.

**17. Zj. M. K.** në cilësinë e anëtarit të komisionit nxjerrjes jashtë përdorimit.

**18. Zj. E. P.** në cilësinë e anëtarit të komisionit nxjerrjes jashtë përdorimit.

për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatim të urdhrat titullarit nr. 108, datë 13.12.2010 për mos nxjerrjen jashtë përdorimit të 2 autobuzave të NPP, për të cilat nuk është kryer asgjësimi i plotë i tyre për ti çmontuar si skrap dhe si pjesë këmbimi, por ata ruhen sipas kontratës datë 6.02.2012 të qirasë për vitin 2012 edhe pas shkarkimit tyre nga kontabiliteti i vitit 2011, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”.

Për sa më sipër është mbajtur proces verbali nr. datë.....

**19. Zj. A. M.** me detyrë financiare në Ndërmarrjen Punëve Publike njësi vartëse e bashkisë Pogradec.

**20. Zj. M. K.** ish-financiare në Ndërmarrjen Punëve Publike njësi vartëse e Bashkisë Pogradec.

**21. Z. N. Sh.** dispeçer në Ndërmarrjen Punëve Publike njësi vartëse e Bashkisë Pogradec.

**22. Zj. D. K.** përgjegjësen e degës teknike, në Ndërmarrjen Punëve Publike njësi vartëse e Bashkisë Pogradec, për shkeljet e mëposhtme:

-Për lejimin e 2 autobuzave të transportit urban në linjën Pogradec-Tushemisht për 3 vite radhazi me humbje, ku me të ardhurat nga shitja e biletave nuk janë mbuluar shpenzimet e veta për vitin 2009, 2010 dhe 2011, në kundërshtim me nenin 2, 5/1, 8 etj të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për mos marrjen e masave për zgjidhjen e kësaj situatë në kohën e duhur, për mos kryerje analizash dhe mungesë propozimi tek titullari, për bllokimin e autobusëve ose lënien në përdorim të 1 autobusi, çka do të ulte humbjen dhe do kurseheshin shpenzimet për pagat e shofereve dhe faturinove.

-Për lejimin e pagesave të qirave jashtë afatit kontraktin për vitin 2011 për vlerën 83,200 lekë në 4 raste dhe për llogaritje të penaliteteve për vonesat e pagesës të qirave.

Për sa më sipër është mbajtur proces verbali nr. 10, datë 5.10.2012.

Veprime në kundërshtim me kontratat përkatëse dhe me VKM nr. 162, datë 7.3.2007, nr. 1712, datë 24.12.2008, nr. 316, datë 8.4.2009, ndryshuar me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për dhënie me qira ose enfiteoze të pasurive ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”.

**23. Zj. K. H.** drejtoreshë e kopshtit për shkeljet e mëposhtme:

**24. Zj. H. K.** drejtoreshë e çerdhes, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos vjeljen e 14 debitorëve të çerdhes qytetit për vlerën 30,700 lekë për vitin 2011.

-Për mos vjeljen e 96 debitorëve të kopshtit për vlerën 275,880 lekë për vitin 2011.

-Për mos pagesë periodike të kuotave ushqimore nga familjarët e kopsht-çerdheve, dhe për vonesa në arkëtimin e tyre për periudha të gjata deri 1 vit.

-Për lejimin e trajtimit ushqimor të fëmijëve për vitin 2012 pa bërë pagesën e vitit 2011.

-Për mos marrjen e masave për arkëtimin e debitorëve kopsht-çerdhes.

Për sa më sipër është mbajtur proces verbali nr. 7, datë 21.9.2012.

Veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”.

**25. Z. M. J.** me detyrë supervisor i shërbimeve publike, për shkeljet e mëposhtme:

**26. Z. F. J.** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike, për shkeljet e mëposhtme:



-Për mangësi në mbikëqyrjen dhe kontrollin e shpenzimeve për pastrimin e qytetit të cilat zënë peshë të konsiderueshme në shpenzimet e buxhetit bashkisë.

-Për disa kontrole formale të punimeve, pasi zbritjet për punimet e pakryera kanë qenë të papërfillshme për të gjithë vitin 2011 në vlerat nga 800 lekë deri 2000 lekë/muaj.

-Për mos zbritje punimesh të pakryera të deklaruara nga vetë supervizori, për zërin fshirje e larje rrugësh në disa zona ku është përcaktuar sipërfaqja për çdo rast, ndërsa nga ana tjetër nuk ka zbritje për shërbimet e pakryera të konstatuara, por ka lënë detyra për përmirësim në të ardhmen, në një kohë që firma paguhet për punën e bërë në sasi e cilësi sipas kërkesave të kontratës.

-Për mungesë analize për efektivitetin e shpenzimeve të pastrim-gjelbërimit të qytetit, pasi vetëm 30 % mbulohen nga të ardhurat e taksës pastrim-gjelbërimit, ndërsa 70 % përballohen nga buxheti.

Veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” etj.

## **E. KALLËZIM PENAL**

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar “Për prokurimin publik” dhe ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

**1. Z. A. Sh.** me detyrë Kryetar i Bashkisë Pogradec, për :

1-Mungesë përgjegjshmërie në drejtimin e institucionit ku janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore në aktivitetin e institucionit të shoqëruara me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në shumën **47,911,128 lekë për periudhën e audituar.**

2-Veprime në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e përgjegjësiive ligjore për:

a) Dhënie shesh dhe leje ndërtimi fondacionit “E.-P.”, themeluar prej tij dhe zotërues 100 % i aksioneve të fondacionit.

b) Lidhje kontratë qiraje midis Bashkisë dhe fondacionit “E.-P.”, themeluar prej tij dhe zotërues 100 % i aksioneve të fondacionit për ambiente për institucione të treta shtetërore.

3-Propozimin individual të tij në KB për marrje vendimi jo të ligjshëm, dhe në cilësinë e Kryetarit të KT dhe KRRT për kalimin nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT të sheshit dhe lejes së ndërtimit për ndërtimin në pronë shtetërore të pistës në liqen, para hotel “E..” (Ish-turizmi), financuar nga subjekti privat dhe që shfrytëzohet prej subjektit privat në mënyrë të kundraligjshme. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 32, pika e), me Ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, neni 35, me Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, neni 2, germa “b”, me Ligji nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, neni 3.

4-Kalimin, në cilësinë e Kryetarit të KT dhe KRRT, nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT për 49 SUP dhe 75 leje sheshit dhe leje ndërtimit në zonën e qendrës së qytetit për periudhën e audituar në mungesë të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Miratuar në KRRTRSH dhe Studimit Urbanistik Pjesor për Qendrën e Qytetit të miratuar në KRRTRSH në zbërthim të Planit të Përgjithshëm Rregullues, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 9 dhe Vendimin e KRRTRSH nr. 3, datë 21.8.2002 “Për dhënie e lejeve të ndërtimit në qendrat e qyteteve”, pika 1, ku përcaktohet se “Sheshet dhe lejet e ndërtimit, për objekte që propozohen brenda zonës së qendrave të qyteteve për Bashkinë e Tiranës dhe bashkitë e kategorisë së parë (sipas nenit 15 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”) të shqyrtohen vetëm pas miratimit përfundimtar në KRRTRSH të studimeve të reja për këto qendra sipas përcaktimeve ligjore në fuqi”.

5- Kalimin, në cilësinë e Kryetarit të KT dhe KRRT, nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT për 48 praktika, me shkelje të kondicioneve urbanistike në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

6- Procedurën e ndjekur në tenderin “Vepra arti” në kundërshtim me ligjin 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, rrjedhë e të cilit është dhe llogaritja e regjistrimi në kontabilitet i fondit limit më tepër në vlerën 1,333,333 lekë, në kundërshtim me pikën 2 Llogaritja e vlerës së kontratës të Kreu – t të II të VKM nr. 1, datë 10.1.2007.

Në tenderët me objekt:

- “Rikonstruksioni i Shëtitores 10 Dëshmorët e Pojskës”, shtesë kontrate me vlerë 8,851,320 lekë,

- “Rikonstruksioni i stadiumit dhe ambienteve rreth tij”, shtesë kontrate me vlerë 9,074,469 lekë, për këto dy tenderë ka ndjekur procedurën e prokurimit “*Me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës*”, në kundërshtim me pikën 5 “Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” paragrafi 11 i KREU –t të V Llojet dhe përzgjedhja e procedurës, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007.

**2. Z. E. V.** me detyrë nënkryetar i Bashkisë Pogradec, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike për:

1-Projektvendimin (pa numër) të datës 15.10.2008 “Për vënien në dispozicion të truallit për ndërtimin e platformës-pistë përballë Enkelanës” drejtuar KB i shoqëruar me një relacion ku i drejtohet këshilltarëve duke ju bërë të qartë se “Projektvendimi i paraqitur vjen si pasojë e zbatimit të studimit urbanistik për sheshin e qendrës ku janë parashikuar ndërtimi i kompleksit moli dhe platformë – pistë në liqen përballë sheshit të qendrës..... Pjesë e këtij studimi janë edhe dy mole nga të cilat njëri do të financohet nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, ndërsa moli i vogël në krahë të tij do të ketë funksion piste dhe do të financohet nga biznesi privat duke bërë të mundur realizimin e gjithë studimit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 32, pika e), me Ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, neni 35, me Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajshme të shtetit”, neni 2, germa “b”, me Ligji nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, neni 3.

2-Kalimin, në cilësinë e Anëtarit të KT dhe KRRT, nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT për 49 SUP dhe 75 leje sheshit dhe leje ndërtimit në zonën e qendrës së qytetit për periudhën e audituar në mungesë të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Miratuar në KRRTRSH dhe Studimit Urbanistik Pjesor për Qendrën e Qytetit të miratuar në KRRTRSH në zbatim të Planit të Përgjithshëm Rregullues, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 9 dhe Vendimin e KRRTRSH nr. 3, datë 21.8.2002 “Për dhënien e lejeve të ndërtimit në qendrat e qyteteve”, pika 1, ku përcaktohet se “Sheshet dhe lejet e ndërtimit, për objekte që propozohen brenda zonës së qendrave të qyteteve për Bashkinë e Tiranës dhe bashkitë e kategorisë së parë (sipas nenit 15 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”) të shqyrtohen vetëm pas miratimit përfundimtar në KRRTRSH të studimeve të reja për këto qendra sipas përcaktimeve ligjore në fuqi”.

3- Kalimin, në cilësinë e Anëtarit të KT dhe KRRT, nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT për 48 praktika, me shkelje të kondicioneve urbanistike në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

4. Në cilësinë e kryetarit të KVO për shkak të s kualifikimit të gabuar të BOE “N..92” sh.p.k dhe “E..” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i stadiumit dhe ambienteve rreth tij”, i cili duhet të shpallej fitues pasi ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 41,942,696 lekë, ose 3,429,652 lekë më pak se sa oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**3.Z. P. Z.** me detyrë Nënkrjetar i Bashkisë, Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe në cilësinë e Sekretarit të KRRT-së për:

1. Kalimin nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT të sheshit dhe lejes së ndërtimit për ndërtimin në pronë shtetërore të pistës në liqen, para hotel “E...” (Ish-turizmi), financuar nga subjekti privat dhe që shfrytëzohet prej subjektit privat në mënyrë të kundërligjshme. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 32, pika e), me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, neni 35, me Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, neni 2, germa “b”, me Ligji nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, neni 3.

2. Kalimin nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT për 49 SUP dhe 75 leje sheshit dhe leje ndërtimi në zonën e qendrës së qytetit për periudhën e audituar në mungesë të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Miratuar në KRRTRSH dhe Studimit Urbanistik Pjesor për Qendrën e Qytetit të miratuar në KRRTRSH në zberthim të Planit të Përgjithshëm Rregullues, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, neni 9 dhe Vendimin e KRRTRSH nr. 3, datë 21.8.2002 “Për dhënien e lejeve të ndërtimit në qendrat e qyteteve”, pika 1, ku përcaktohet se “Sheshet dhe lejet e ndërtimit, për objekte që propozohen brenda zonës së qendrave të qyteteve për Bashkinë e Tiranës dhe bashkitë e kategorisë së parë (sipas nenit 15 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”) të shqyrtohen vetëm pas miratimit përfundimtar në KRRTRSH të studimeve të reja për këto qendra sipas përcaktimeve ligjore në fuqi”.

3. Kalimin nga Urbanistika dhe KT për shqyrtim dhe miratimin nga KRRT për 48 praktika, me shkelje të kondicioneve urbanistike në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

4. -Për mungesë përgjegjshmërie në ushtrimin e detyrës në llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve financiare për financimin e studimeve urbanistike dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë e shoqëruar me dëm ekonomik në shumën 13,323,563 lekë në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

5. Në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkak të s kualifikimit të gabuar të B. “M. 92” sh.p.k dhe “E...” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i stadiumit dhe ambienteve rreth tij”, i cili duhet të shpallej fitues pasi ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 41,942,696 lekë, ose 3,429,652 lekë më pak se sa oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**4. Zj. A. B.** në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkak të s kualifikimit të gabuar të B. “M. 92” sh.p.k dhe “E...” sh.p.k në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i stadiumit dhe ambienteve rreth tij”, i cili duhet të shpallej fitues pasi ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë 41,942,696 lekë, ose 3,429,652 lekë më pak se sa oferta e shpallur fituese, e cila përbën dëm ekonomik. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**5. Z. V. M.** me detyrë Drejtor i Muzeve, në cilësinë e ish-Nën/Kryetarit të Bashkisë pasi:

Nga auditimi i zhvilluar në lidhje me objektet e marra me qera nga ana e Bashkisë Pogradec, rezultoi se kjo bashki ka marrë me qira ambiente ndërtese dhe oborre të fondacionit “EDU-PRO”, për nevoja të filialit të Universitetit Fan Noli për vitin 2010, 2011 e në vazhdim, në bazë të kontratës së datës 15.9.2010 e lidhur për një afat 5-vjeçar nga data 1.9.2010 deri në datën 1.9.2015, parashikohet kryerja e pagesës 150 lekë/m<sup>2</sup> për një sipërfaqe totale prej 1,448 m<sup>2</sup> e përlllogaritur në 217,200 lekë në muaj.

Si rrjedhojë, pagesa e qirasë ndaj fondacionit “E.-P.” nuk është për nevoja të Bashkisë Pogradec, por për nevoja të filialit të Universitetit Fan Noli i cili varet nga Universiteti i Korçës dhe MASH.

Kontrata e datës 15.9.2010 është lidhur dhe nënshkruar ndërmjet dy punonjësve të bashkisë, ku për palën qiramarrëse (fondacionin) ka nënshkruar znj. K. N. me detyrë shefe kabinetit (Në momentin e lidhjes së kontratës Drejtore e Burimeve njerëzore) dhe njëkohësisht drejtore ekzekutive e fondacionit dhe për palën qiradhënëse (bashkia) kanë nënshkruar z. E. V. me detyrë n/kryetar i bashkisë dhe z. V. M. me detyrë n/kryetar i bashkisë).

Gjithashtu veprimet e mësipërme janë kryer në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, pasi likuidimi dhe marrja e vlerave monetare si pasojë e kësaj kontrate bëhet nga i njëjti person e vërtetuar kjo edhe sipas certifikatës pronësisë datë 5.3.2009 dhe kontratës datë 15.9.2010, si dhe sipas urdhërpagesës nr. 280, datë 5.7.2012.

Pavarësisht se Kryetari i Bashkisë ka deklaruar paraprakisht ekzistencën e konfliktit të interesit dhe nuk ka nënshkruar kontratën, ai me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk e ka shmangur atë, pasi ka lejuar nënshkrimin e kontratës datë 15.9.2010 nga 3 vartësit e tij për 2 palët kontraktuese, punonjës të administratës të Bashkisë Pogradec, përkatësisht nga 2 n/kryetarët (z. E. V. dhe z. V. M. ish nënkryetar) dhe shefja e kabinetit e cila është njëkohësisht dhe drejtore ekzekutive e fondacionit, veprime këto në kundërshtim me nenin 1, nenin 3/1,2,3,4/b nenin 5/d, neni 6/1 neni 21/1/a dhe pika 2, neni 29/a, neni 37/3, 5/a dhe 8, neni 38/1/i, ii, neni 40/1 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe me nenin 37, 38, 42 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi Procedurave Administrative”, si dhe me pikën 4/1 neni 88 të udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit vitit 2011”.

**6. Zj. K. N.** me detyrë ish drejtoreshë e burimeve njerëzore dhe aktualisht shefe e Kabinetit të Bashkisë Pogradec, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos shmangen e konfliktit të interesit, për nënshkrimin e kontratës datë 15.9.2010, për marrjen me qira të ambienteve të ndërtesës të fondacionit E.-P. për nevoja të filialit të Universitetit Fan Noli Pogradec, pasi objekt i qiramarrjes dhe qiradhënies është kryetari i bashkisë. Shefja e kabinetit ka firmosur kontratën për palën e fondacionit duke patur vartësi direkt nga kryetari i bashkisë, veprim që bie ndesh me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi Procedurave Administrative”.

-Për marrje dhe përdorim karburanti me fletëdalje nga magazina jashtë kërkesave ligjore dhe për fletudhëtime të parregullta që nuk justifikojnë konsumin e karburantit, sipas fletëdaljes nr. 35, datë 20.4.2011, çka ka krijuar një dëm ekonomik për vlerën 436,770 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”.

-Për pranim të punonjësve në pozicione pune në kundërshtim me kërkesat ligjore në 3 raste, në kushtet e mungesës së arsimit profesional, mungesës përvojës së punës dhe jashtë profilit të vendit punës, në kundërshtim me nenin 12 pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për periudhën që ushtronte detyrën e drejtoreshës burimeve njerëzore.

**Shënim:** Auditimi u krye nga audituesit Albert Thoma, Fatmir Zilja, Besim Bileri, Milo Pano, Dorino Meço, Xhemal Luka dhe Alush Zaçe. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**